

VENDIM
Nr.204, datë 30.6.2011

**PËR RINOVIMIN E LICENCËS DHE MIRATIMIN E NDRYSHIMEVE NË TË DHËNAT E
PARAQITURA NË KËRKESËN PËR MARRJE LICENCE TË SHOQËRISË “SCORPION” SHPK,
LICENCUAR PËR SUBJEKTIN RADIOFONIK ME PËRSËRITËS “WORLD FAMILY”**

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, i përbërë nga:

Endira Bushati	kryetare
Alban Karapici	zëvendëskryetar
Suela Musta	anëtare
Sami Neza	anëtar
Gent Ibrahim	anëtar (në mungesë)
Zylyftar Bregu	anëtar,

pasi mori në shqyrtim çështjen me:

OBJEKT: Për shqyrtimin e kërkesës së paraqitur nga subjekti “Scorpion” sh.p.k.

BAZA LIGJORE: Neni 7 pika 21, neni 25 dhe neni 30 i ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullorja “Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr.1, datë 29.1.2010 të KKRT-së,

VËREN SE:

KKRT-ja, me vendimin nr.103, datë 24.9.2010 “Mbi shqyrtimin e dokumentacionit për rinovimin e licencës së subjektit radiofonik me përsëritës World Family”, ka vendosur mosrinovimin paraprak të licencave të shoqërisë “Scorpion” sh.p.k. për operatorin radiofonik privat me përsëritës “Radio World Family”, për shkaqet e parashtuara në vendim. Subjekti kishte të drejtë që brenda 30 ditëve të parashtonte pretendimet dhe plotësimet përkatëse lidhur me këto vendime të KKRT-së.

Me shkresën e datës 2.12.2010, shoqëria “Scorpion” sh.p.k. ka depozituar në KKRT dokumentacionin plotësues për rinovimin e licencës së subjektit radiofonik me përsëritës “Radio World Family”. Gjatë vlerësimit dhe shqyrtimit të dokumentacionit plotësues rezultoi se dokumentacioni për rinovimin e licencës kishte përsëri mangësi. Në këto kushte, KKRT-ja me vendimin nr.108, datë 28.3.2011 “Mbi caktimin e një afati të ri për paraqitjen e plotësimeve të dokumentacionit për rinovim licence të subjektit radiofonik me përsëritës “Radio World Family”, vendosi të shtyjë afatin për paraqitjen e plotësimeve të dokumentacionit për rinovim licence, duke i dhënë të drejtën subjektit “Scorpion” sh.p.k. për të paraqitur plotësimet dhe mangësitë përkatëse brenda 30 ditëve.

Me shkresën e datës 26.5.2011, shoqëria “Scorpion” sh.p.k. ka depozituar pranë KKRT-së plotësimet, mangësitë dhe sqarimet përkatëse. Konkretisht subjekti ka depozituar:

- Deklaratat noteriale nr.rep.2061, nr.kol.1154, datë 26.5.2011 dhe nr.rep.2062, nr.kol.1155, datë 26.5.2011, të firmosura përkatësisht nga ortakët Prenka Lazraj dhe shoqata “Radio Maria”;
- Programacionin e grupuar sipas karakterit të emisionit;
- Kërkesën e depozituar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për ndryshimin e objektit të veprimtarisë së shoqatës “Radio Maria”.

Në vazhdim, me shkresën e datës 8.6.2011, subjekti ka depozituar pranë KKRT-së vendimin nr.2066/6, datë 8.6.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, sipas të cilit rezultoi se objekti i veprimtarisë i shoqatës “Radio Maria”, “Ka për qëllim ushtrimin e aktivitetit radiofuzionit sonor e publikimin e periodikëve me karakter kulturor, etnik, nëpërmjet publikimit të prodhimeve editoriale, transmetimeve të programeve të ndryshme, të vetëprodhuara ose të blera nga të tretët”.

Ndërsa, për sa u përket ndryshimeve të ndodhura në shoqërinë “Scorpion” sh.p.k., me shkresën e protokolluar pranë KKRT-së me nr.1854 prot., datë 13.12.2010, shoqëria “Scorpion” sh.p.k. ka paraqitur pranë KKRT-së njoftimin në lidhje me ndryshimet në strukturën e ortakëve të shoqërisë. Subjekti njofton se:

“... te shoqëria “Scorpion” sh.p.k. janë bërë ndryshimet si më poshtë vijon:

2. Është larguar ortaku Julian Priska dhe është shtuar ortaku Prenka Lazraj.”

Njoftimi është bërë në mbështetje të nenit 30 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, “I licencuari detyrohet të njoftojë Këshillin Kombëtar të Radios dhe Televizionit për çdo ndryshim të të dhënave që ka paraqitur në kërkesën

për marrjen e licencës...”.

Sa më sipër, KKRT-ja e gjen të drejtë kërkesën e paraqitur nga subjekti.

PËR KËTO ARSYE,

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, në mbështetje të nenit 7, pika 21, nenit 25 dhe nenit 30 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe mbështetur në kërkesën e subjektit,

VENDOSI:

1. Rinovimin e licencës së subjektit radiofonik me përsëritës “Radio World Family” për ritransmetimin e programeve të huaja.

2. Miratimin e ndryshimeve në të dhënat e paraqitura në kërkesën për marrje licence.

3. Kushtet e licencës sipas pikës 1 të këtij vendimi mbeten të pandryshuara.

4. Ngarkohet administrata e KKRT-së për zbatimin e këtij vendimi.

5. Pika 1 e këtij vendimi i shtrin efektet nga data 15.10.2009.

6. Pika 2 e këtij vendimi hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati